

SALI KADRIA**QËNDRIMI I AUTORITETEVE AUSTRO-HUNGAREZE
NDAJ POPULLSISË DHE KLERIT MYSLIMAN SHQIPTAR
GJATË VITEVE 1916-1918**

Pas hyrjes së trupave austro-hungareze në viset shqiptare nga fundi i vitit 1915 deri në mesin e muajit janar 1916, shqiptarët e krishterë dhe myslimanë i pritën ato gati si “çlirimtarë”. Arsyeja ishte se nga fundi i shek. XIX deri në fillimin e Luftës së Parë Botërore, Austro-Hungaria kishte mbështetur interesat kombëtare shqiptare. Ajo ishte një fuqi me të cilën shqiptarët nuk kishin patur përplasje të forta, ndryshe nga sa kishte ndodhur me serbët¹. Për të kuptuar më qartë, qëndrimin e mbajtur nga autoritetet austro-hungareze ndaj popullsisë dhe klerit mysliman shqiptar, duhen parë me kujdes disa aspekte të rëndësishme: 1. Cilat ishin marrëdhëniet që ndërtuan autoritetet ushtarake dhe civile austro-hungareze në raport me popullsinë myslimane dhe atë katolike? 2. Çfarë qëndrimi mbajti qeveria austro-hungareze kundrejt rritjes së ndikimit xhonturk mbi popullsinë myslimane shqiptare? 3. Çfarë kontributi pati prania austro-hungareze në drejtim të forcimit të institucioneve të fesë islame në Shqipëri?

**Marrëdhënia e autoriteteve ushtarake austro-hungareze
me popullsinë myslimane shqiptare në fillim të okupimit**

Në fillim të vitit 1916, drejtuesit e Korpuskomandës XIX të ushtrisë austro-hungareze në Shqipëri, vendosën të rekrutonin afro 8 mijë vullnetarë shqiptarë, si forca ndihmëse për trupat e ushtrisë së tyre, por edhe për krijimin e trupave të xhandarmërisë (milicisë)* shqiptare².

¹ Bernd J. Fischer, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*, përkthyer nga Krenar Hajdëri, Tiranë: Çabej, 2004, f. 24; *Historia e Popullit Shqiptar*, vëllimi III (Periudha e Pavarësisë 28 nëntor 1912 – 7 prill 1939), botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007, f. 84.

* Në disa prej dokumenteve arkivore austro-hungareze të përkthyer në gjuhën shqipe që ndodhen në fondet e Arkivit të Institutit të Historisë, Tiranë, përdoret fjala xhandarmëri për këto trupa, në të tjera gjenden me emërtimin milici.

Megjithëse nuk jepen shifra konkrete, objektivi i mësipërm ushtarak nuk u arrit të realizohej. Në relacionet diplomatike thuhej se, në radhët e trupave “vullnetare” në pjesën e Shqipërisë së Veriut u përfshinë kryesisht shqiptarë katolikë, ndërsa shqiptarët myslimanë u angazhuan me përjashtime të vogla³. Dështimin që pësuan në procesin e rekrutimit të vullnetarëve në trupat e xhandarmërisë shqiptare në rajonin e Shqipërisë së Mesme, autoritetet ushtarake austro-hungareze ia ngarkuan ndikimit të elementëve fanatikë myslimanë në mesin e popullsisë së Tiranës, Shijakut dhe të Kavajës⁴.

Për arritjen e qëllimit që i kishin vënë vetes, drejtuesit ushtarak në Shqipëri ngarkuan klerikët myslimanë shqiptarë që të hartonin listat e të rinjve shqiptarë që i përkisnin këtij besimi fetar, për t’u mobilizuar përkrah trupave austro-hungareze. Mirëpo, këta të rinj u përpoqën me të gjitha mënyrat për t’u fshehur, që t’i shpëtonin rekrutimit “vullnetar” ushtarak. Për këtë shkak, autoritetet ushtarake filluan të merrnin masa represive kundër atyre të rinjve, që përpiqeshin t’i shmangeshin mobilizimit ushtarak. Po kështu, u vendos që të ndëshkoheshin me gjobë në masën 20 mijë korona austro-hungareze, edhe klerikët myslimanë që nuk paraqisnin brenda afatit listat emërore të “djemve vullnetarë” shqiptarë⁵.

Fushata e rekrutimit me dhunë si dhe uzurpimi i shtëpive nga ushtarët dhe oficerët austro-hungarezë, acaruan popullsinë myslimane shqiptare. Në rritjen e pakënaqësisë së tyre ndikuan rekuizimet e kryera me forcë, kufizimi i blerjes jashtë vendit të produkteve ushqimore bazë⁶, si dhe blerja nga ana e trupave austro-hungareze të prodhimeve të tyre me

² “Lajme vendit. Vullnetarët e Shqypniës”, në *Posta e Shqypnies*, nr. 54, Shkodër, 13 qershor 1917, f. 3.

³ *Haus – Hof und Staats Archiv, Wien Politisches Archiv Albanien* (më tej: *HHStA, PA, A*), në *Arkivin e Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), Vj. 26-17-1738. Relacion i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez A. Kral, drejtuar baronit Stefan Burian, ministër i Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 12 qershor 1916.

⁴ *Po aty, AIH*, Vj. 26-19-1921, Referat nr. 75 “Mbi gjendjen në Shqipërinë e Mesme” i Zyrës së komandës Imperiale dhe Mbretërore në Elbasan, Elbasan, 3 qershor 1916.

⁵ “Vullneti i gjytetasve nen dorë ushtrake t’Austris”, në *Besa Shqyptare*, nr. 8, Shkodër: 3 dhjetor 1918, f. 2.

⁶ Lef Nosi, *Dokumente historike për t’i shërbye historisë tonë kombëtare*, përgatitur dhe redaktuar nga Marenglen Verli dhe Ferit Duka, botim i Institutit të Historisë, Tiranë: Nënë Tereza, 2007, “Masa për ushqimin e Vendit. Dekreti i Korpskomandës”, f. 256-257.

kartëmonedha dhe jo me monedha të çmuara, siç ishin mësuar më parë. Administrata ushtarake kishte mbajtur një qëndrim aspak miqësor ndaj ankesave të popullsisë shqiptare, të cilat sipas raportimeve të Korpuskomandës XIX, “ankesat kishin marrë formën e një lumi që vazhdimisht vinte duke u fryrë”⁷. Kjo pakënaqësi u shfaq më tepër në mesin e popullsisë myslimane të Shkodrës dhe të rrethinave të saj, pasi ajo gjatë periudhës osmane kishte qenë e përjashtuar nga rekrutimi i detyrueshëm ushtarak. Prandaj, gjatë vitit 1916 pati protesta nga ana e banorëve myslimanë të Shkodrës kundër autoriteteve ushtarake austro-hungareze. Për të kuvenduar këtë çështje sipas zakoneve të vjetra shqiptare, në datat 14-16 prill 1916, u mbajt një mbledhje nga popullsia muhamedane në “Xhaminë Plakë” të Shkodrës. Përfaqësuesit e popullsisë myslimane hartuan një memorandum, të cilin ia dorëzuan autoriteteve drejtuese ushtarake. Në këtë dokument, thuhej se, për shkak të rregullave të fesë së tyre, ku parashikohej që burrat dhe gratë jetonin në mjedise të ndara brenda shtëpive të tyre, popullsia myslimane nuk ishte e gatshme të mirëpriste ushtarë në shtëpitë e familjet e tyre. Meqenëse gjatë viteve të fundit kjo popullsi kishte vuajtur shumë nga mundimet e shkaktuara nga armiqtë dhe veçanërisht nga zija e bukës, vendimi për detyrimin e saj për t’u marrë me gjimnastikë dhe ushtrime ushtarake nuk i shërbente përmirësimit të shëndetit fizik dhe konsiderohej prej tyre si i parakohshëm. Gjithashtu, ata luteshin që arat, fushat dhe kopshtet e tyre të ruheshin si dhe të evitoheshin dëmtimet sepse në mesin e popullsisë së fshatrave kishte rezerva për furnizimin e qytetit me ushqime⁸.

Fejzi Alizoti që mbante detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Financave të Shqipërisë, shprehej se, mbledhja ishte organizuar prej tij, por pa marrë leje nga komanda austro-hungareze. Të shqetësuara nga ky fakt, trupat austro-hungareze ndërhyjnë dhe shpërndanë me forcë mbledhjen. Nga përplasja me forcat austro-hungareze u plagosën dy

⁷ Ledia Dushku, “Shqiptarët përballë ushtarakëve dhe diplomatëve austro-hungarezë (1914-1916)”, në *Studime historike*, nr. 3-4, botim i Institutit të Historisë pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike, Tiranë: 2016, f. 80-81.

⁸ Hasan Bello, “Roli i Austro-Hungarisë për organizimin e institucioneve të fesë islame në Shqipëri në vitet 1916-1918” në *Gjurmime albanologjike*, nr. 43, Prishtinë: 2013, f. 218-219; *HHStA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 26-17-1776. Raport i kolonel Forkes, drejtuar kontit Burian, ministër i Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 24 prill 1916.

shqiptarë, si dhe u arrestuan 690 deri 1 000 qytetarë të tjerë⁹. Ndërmjet shqiptarëve të burgosur ishin edhe personalitete të njohura në Shkodër, si Xhemal Efendi dhe Muharrem Agë Kazazi, i cili mori përsipër organizimin e mbledhjes¹⁰. Për të njëjtën ngjarje shkruan në kujtimet e tij edhe Syrja Bej Vlora. Mirëpo, ai shprehet se, shkaku i organizimit të mbledhjes ishte çështja e zaptimit të shtëpive të shqiptarëve nga ushtarët austro-hungarezë. Ndërkaq, ai pohon se, numri i të arrestuarve arrinte në 900 vetë¹¹.

Shfaqja e pakënaqësisë dhe shpërthimi i protestave lokale të shqiptarëve kundër forcave ushtarake austro-hungareze lidheshin edhe me urdhrin e shpallur më 29 prill 1916 nga komanda e lartë ushtarake. Sipas urdhrit kërkohej dorëzimi i armëve nga ana e popullsisë civile si dhe ndërprerja e gjakmarrjes mes shqiptarëve. Pika 2 e tij, parashikonte në mënyrë të prerë, që çdo person, i cili kryente vrasje dhe shpallej fajtor, dënohej me varje¹². Refik dhe Murat Bej Toptani protestuan pranë Alfred Rappaport, funksionar i lartë në Ministrinë e Jashtme austro-hungareze në Vjenë, jo vetëm për rekuizimet por edhe për çështjen e rekrutimit me forcë të “vullnetarëve” shqiptarë¹³.

Për të zbutur situatën e krijuar, komandanti i Përgjithshëm i trupave austro-hungareze në Shqipëri I. Trollmann, nxori urdhrin për shpalljen në mjediset publike dhe leximin në xhamitë e Shqipërisë të

⁹ *HHSStA, PA, A, në AIH, Vj. 26-18-1802*. Raport i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez Kral, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 10 tetor 1916; Xhevat Repishti, “Revolta e masave të Shkodrës në pranverën e vitit 1916 kundër pushtuesve austro-hungarezë”, në *Studime historike*, nr. 1, Tiranë: 1973, f. 73-74; *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, botim i Institutit të Historisë së Akademisë së Studimeve Albanologjike, Tiranë: KRISTALINA-KH, 2017, f. 379.

¹⁰ Fejzi Alizoti, *Kujtimet e jetës sime politike, 1891-1921*, Tiranë: Deaprint, 2012, f. 106.

¹¹ Syrja Vlora, *Kujtime – Nga fundi i sundimit osman në Luftën e Vlorës*, përgatitur për botim dhe redaktuar nga Marenglen Verli dhe Ledia Dushku, Tiranë: Iceberg, 2013, f. 160.

¹² L. Nosi, *Dokumente historike për t'i shërbye historisë tonë...*, f. 257-258. Proklamë e kryekomandantit austriak me titullin “Shqypëtarë!”, nxjerrë nga kryekomandari i ushtriës p. e. m. n’ Shqypnië: Trollmann, Shkodër, më 29 Prill 1916; Peter Bartl, *Shqiptarët. Nga Mesjeta deri në ditët tona*, përkthyer nga Afrim Koçi, Tiranë: Shtëpia e Dialog & Komunikimit, 2008, f. 180.

¹³ *HHSStA, PA, A, në AIH, Vj. 26-17-1794*. Letër sekrete e konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez Kral, drejtuar konsullit të Përgjithshëm A. von Rappaport në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 29 shtator 1916.

fetva - së* mbi Luftën e Shenjtë të shpallur më 23 nëntor 1914 nga Sheh-Ul-Islami i Stambollit. Në këtë *fetva* u bëhej thirrje myslimanëve të të gjithë botës që të bashkëpunonin me bllokun Austro-Gjerman kundër Britanisë së Madhe, Francës dhe Ruisë. Komisari civil Kral, raportonte se, myftiu i Shkodrës, Mehmet Tahiri duke u shpjeguar besimtarëve të mbledhur në xhami u shpreh se ajo u bënte thirrje shqiptarëve myslimanë që t'u bindeshin autoriteteve civile e ushtarake austro-hungareze kundër shteteve armike të Antantës dhe mbështetësve të tyre në Shqipëri, të cilët zhvillonin luftë kundër Kalifit. Kjo *fetva* u shtyp në një numër të madh kopjesh dhe iu shpërnda të gjithë hoxhallarëve të vendit që ta lexonin përpara popullit¹⁴. Ministria e Punëve të Jashtme në Vjenë porosiste Komisararin civil Kral që t'u kërkonte autoriteteve ushtarake në Shqipëri, të tregoheshin më të kujdesshme lidhur me zbatimin e masave të ashpra ndaj klerikëve shqiptarë. Sipas drejtuesve të diplomacisë vjeneze, masa e internimeve ndaj klerikëve duhej të merrej vetëm në rastin kur bëhej fjalë "për individë me të vërtetë të dyshimtë dhe të kompromentuem rëndë politikisht"¹⁵.

Acarimi i marrëdhënieve të autoriteteve ushtarake austro-hungareze me popullsinë shqiptare në përgjithësi, dhe atë myslimane në veçanti, nxitën drejtuesit e qeverisë austro-hungareze që të merrnin masa politike për qetësimin e situatës në Shqipëri. Më 23 janar të vitit 1917, komanda austriake në Shqipëri publikoi një proklamantë politike, në të cilën shpallej se qeveria austro-hungareze njihte autonominë e Shqipërisë. Gjithashtu, në këtë dokument, thuhej se, Austro-Hungaria do të përpiqej për të respektuar plotësisht fenë, gjuhën, të drejtat dhe zakonet e lashta të popullit shqiptar. Drejtuesit e kësaj qeverie deklaroronin gjithashtu se shteti i tyre ishte përpjekur gjithmonë që të ruante tërësinë e

* Ky term përdoret në besimin islam, për të shprehur mendimin juridik ose interpretimin që Sheh-ul-Islami, një jurist ose myfti i kualifikuar, mund të japë për çështje që i përkasin ligjit islam.

¹⁴ Hasan Bello, *Marrëdhëniet shqiptaro-turke (1912-1939)*, Tiranë: Kristalina-KH, 2015, f. 123-124; *HHStA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 26-15-1555. Raport i komisarit civil Kral, drejtuar kontit Burian, ministër i Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 7 korrik 1916.

¹⁵ *Po aty*, Vj. 26-4-483. Shkresë nr. 4730 e Ministrisë së Punëve të Jashtme austro-hungareze, drejtuar konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez Kral në Shkodër, Vjenë, 25 shtator 1916.

Shqipërisë dhe se, trupat austro-hungareze kishin ardhur në Shqipëri si “mike”, duke ndjekur armikun e përbashkët¹⁶.

Qëndrimi i autoriteteve ushtarake dhe civile austro-hungareze ndaj rivalitetit mes shqiptarëve myslimanë e të krishterë

Në pranverë të vitit 1917 u krijua një krisje në marrëdhëniet midis popullsisë e klerit katolik shqiptar dhe Komisarit civil A. Kral. Shkak i tensionimit të marrëdhënieve midis dy palëve u bë rasti i Preng Bib Dodës. Për shkak të bashkëpunimit të mëparshëm me italianët, Preng B. Doda nuk shihej me sy të mirë nga autoritetet ushtarake dhe civile austro-hungareze¹⁷. Për ta larguar nga Shkodra, autoritetet austro-hungareze e emëruan atë kajmekam [nënprefekt] të Pukës. Për këtë arsye si dhe mosmarrëveshjeve që kishte me A. Kral, autoritetet austro-hungareze vendosën që Preng B. Doda të shkarkohej nga kjo detyrë. Kapedani i Mirditës shfrytëzoi gjendjen e vështirë ekonomike të banorëve të kësaj krahine, duke i shtyrë ata që të ngriheshin kundër administratës austro-hungareze. Preng Bib Doda nxiti një grup shqiptarësh katolikë, të cilët me ndihmën e disa oficerëve austro-hungarezë në Shqipëri, t’i paraqisnin Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë një peticion në trajtë ankese kundër Kral-it. Ata ankoheshin ndaj tij, duke theksuar se, ky i fundit shfaqte preferencë për shqiptarët myslimanë në administratën shqiptare. Në këtë dokument thuhej se, në mjaft raste këta shqiptarë myslimanë kishin qenë bashkëpunëtorë të Esat Pashë Toptanit dhe armiq të Perandorisë Austro-Hungareze. Midis rasteve “preferenciale”, përmendej edhe ai i emërimit të kajmekamit të Lezhës, për të cilin thuhej se Kral kishte caktuar një shqiptar mysliman që të drejtonte një njësi administrative në të cilën “kishte 15 mijë banorë katolikë dhe vetëm 150 banorë myslimanë”. Ky grup shprehej se popullsia katolike shqiptare i ishte përgjigjur urdhrin të rekrutimit ushtarak të lëshuar nga qeveria austro-hungareze, ndërkohë që popullsia muhamedane kishte shfaqur

¹⁶ *Po aty*, Vj. 27-8-819. Telegram shifër i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez Kral, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 28 janar 1917; L. Nosi, *Dokumente historike për t’i shërbye historisë tonë kombëtare ...*, Proklamë e shpallur nga komandanti i përgjithshëm i ushtërës austro-ungare në Shqipëri më një zet e tre të kti muj – “Shqipëtarë!”, f. 273-274; Joseph Swire, *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie*, përkthyer nga Kujtim Ymeri, Tiranë: Dituria, 2005, f. 218.

¹⁷ F. Alizoti, *Kujtimet e jetës sime politike...*, f. 105.

gjithnjë kundërshtime antiqeveritare. Me këtë mënyrë të shprehuri, aludohej se shqiptarët myslimanë ishin kundër pranisë së trupave austro-hungareze në Shqipëri. Sipas tyre, një padrejtësi tjetër që u ishte bërë shqiptarëve katolikë ishte fakti se në Shqipërinë e Mesme, ku popullsia ishte kryesisht myslimane u ndërtuan 134 shkolla, ndërsa në “Shqipërinë veriore ende nuk asht ba gja”. Ata e akuzonin Komisararin civil Kral, se nuk tregonte kujdesin e duhur ndaj klerit katolik dhe se kishte deklaruar se nuk dëshironte të bashkëpunonte me të. Në këto rrethana, përfundonte ankesa, “klери [katolik] po humb influencën dhe prestigjin që ka pasë, për dam të madh të fesë dhe të Monarkisë”¹⁸.

Komisari civil Kral mendonte se arsyeja e pakënaqësisë që shfaqte Preng Bib Doda ndaj tij ishte se detyra e kajmekamit në Pukë, i dukej mjaft e vogël krahasuar me pretendimet e tij. Kaktimin në këtë detyrë, Preng B. Doda e kishte konsideruar si shmangie nga drejtimi i krahinës së Mirditës, ku kishte ndikim. Largimi i tij nga kjo detyrë i krijoi vështirësi të mëdha financiare¹⁹. Këta faktorë kishin ndikuar që ai të kthehej në një personalitet shqiptar pa ndonjë rëndësi të madhe në shoqëri. Për këto arsye, shprehej Kral, ai përpiquej me të gjitha mënyrat që të inskenonte akte sabotazhi kundër trupave austro-hungareze, ndonëse për këtë dyshim nuk ishte arritur ende që të siguroheshin prova të sakta e të besueshme²⁰.

Sipas një raporti të muajit shtator 1917 të Korpuskomandës XIX, i cili shërbente për informacion të brendshëm të autoriteteve austro-hungareze, thuhej qartë se në mesin e shqiptarëve të besimit mysliman kishte filluar të përhapej pakënaqësia, për shkak të favorizimit që u bënin austro-hungarezët shqiptarëve katolikë. Shqiptarët myslimanë i druhashin kësaj politike të ndjekur nga autoritetet vjeneze, pasi ata mund të bëheshin një element i shtypur në Shqipëri²¹. Pakënaqësia dhe rivaliteti i

¹⁸ *HHStA, PA, A, në AIH, Vj. 27-8-852*. Shkresë nr. 113 e Komandës së Përgjithshme austro-hungareze në Shkodër, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 28 mars 1917.

¹⁹ F. Alizoti, *Kujtimet e jetës sime politike...*, f. 105-106.

²⁰ *HHStA, PA, A, në AIH, Vj. 27-9-934*. Raport nr. 222/pol. i konsullit të Përgjithshëm Kral, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 2 dhjetor 1917.

²¹ Sali Kadria, “Austro-Hungarian and Albanian relations during the World War I”, in *Historical Searches – Historijska traganja*, no. 17, published by Institute for History, Sarajevo, Bosnia and Herzegovina: 2018, p. 141; *HHStA, PA, A, në AIH, Vj. 27-9-925*. Raport tepër rezervat i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez Kral, drejtuar kontit Otokar Czernin, Shkodër, 14 tetor 1917.

shfaqur midis përfaqësuesve të popullsisë myslimane dhe katolike shqiptare konfirmohej edhe nga Fejzi Alizoti, i cili gjatë viteve 1916-1918 mbante detyrën e drejtorit të Përgjithshëm të administratës civile shqiptare. Ai shprehej se pas vendosjes së trupave austro-hungareze në Shqipëri, kontradiktat dhe rivaliteti ndërmjet pjesës së popullsisë katolike dhe asaj myslimane të qytetit të Shkodrës u forcuan më shumë se më parë. Për shkak të besimit të njëjtë fetar me trupat austro-hungareze, thekson F. Alizoti, shqiptarët katolikë prisnin shumë më tepër nga autoritetet vjeneze në Shqipëri. Mirëpo, me kalimin e kohës tek ata u krijua përshtypja se autoritetet austro-hungareze në përgjithësi dhe veçanërisht konsulli Kral merrnin parasysh më tepër interesat e shqiptarëve myslimanë. Prandaj, shqiptarët katolikë ankoheshin se administrata e Perandorisë Habsburge parapëlqente më tepër elementin mysliman shqiptar, ndërkohë që myslimanët përpiqeshin të provonin të kundërtën²².

Komisari civil Kral i paraqiti qeverisë austro-hungareze një informacion lidhur me pakënaqësinë dhe rivalitetin e shfaqur në mesin e shqiptarëve myslimanë dhe të krishterë. Në relacionin e tij diplomatik, thuhej se pavarësisht ndonjë rasti të shkëputur, ku vihej re mbështetja e autoriteteve austro-hungareze ndaj popullsisë katolike shqiptare, kjo nuk përbënte një fenomen. Megjithatë, nga përmbajtja e këtij dokumenti dukej qartë se autoritetet civile dhe ato ushtarake austro-hungareze kishin qëndrime të ndryshme ndaj shqiptarëve të dy besimeve fetare. Sipas Kral-it, administrata civile e Monarkisë Dualiste mbante një qëndrim të paanshëm ndaj shqiptarëve të krishterë apo myslimanë. Ky qëndrim lidhej me faktin se drejtuesit e saj kishin nxjerrë mësim dhe krijuar përvojë nga periudha e kaluar në Shqipëri. Ata e kishin të qartë se çdo qeveri, e cila dëshironte që në Shqipëri të korrte fitore të qëndrueshme dhe të siguronte besimin e popullsisë, ose së paku të shumicës së saj, duhej të ishte patjetër e paanshme, e sinqertë, e drejtë dhe t'i trajtonte të gjitha palët në mënyrë të barabartë. Çdo lloj favorizimi në aspektin nacional, konfesional, social ose ekonomik duhej të shmangej me çdo mënyrë. Kral paralajmëronte se nëse një elementi popullsie apo konfesionit fetar i kushtohej vëmendje më e madhe ose ndaj tij tregohesh më shumë simpati, kjo mund të bëhej fatale për të ardhmen e vendit dhe të interesave politike të Austro-Hungarisë në Shqipëri. Prandaj, Kral-i

²² F. Alizoti, *Kujtimet e jetës sime politike...*, f. 104.

theksonte se, “çdo veprimtari qeveritare në Shqipëri kërkon shumë takt dhe një mirëkuptim jashtëzakonisht të thellë për ndjenjat e tjetrit, për rrethin e ideve si dhe për mentalitetin e tij”²³.

Komisari civil A. Kral mendonte se drejtuesit ushtarakë austro-hungarezë në Shqipëri kishin mbajtur një qëndrim të ndryshëm nga ai i administratës civile në raport me shqiptarët. Ai pranonte se përgjegjësia për situatën e krijuar në Shqipëri duhej të kërkohej gjithnjë në “gabimet tona”. Prandaj, ai shprehej se një pjesë e oficerëve austro-hungarezë kishin cenuar të drejtat dhe zakonet e shqiptarëve²⁴. Konsulli Kral theksonte se “zemërimi brenda vendit” filloi me arrestimin dhe burgosjen e mjaft shqiptarëve, të cilët u ndëshkuan për shkak se ata kishin kundërshtuar rekuizimet e ushtrisë austro-hungareze²⁵. Për tejkalimin e situatës së rëndë të krijuar në këtë vend, ai sugjeronte largimin e oficerëve të paarsyeshëm nga Shqipëria si dhe ndërmarrjen e përpjekjeve për afrimin gradual të shqiptarëve të cenuar padrejtësisht si dhe ndaj atyre që ishte përdorur forcë e tepruar²⁶.

A. Kral akuzonte komandantin e Përgjithshëm të trupave austro-hungareze në Shqipëri, gjeneralin Ignaz Trollmann si një ndër shkaktarët kryesorë të situatës së nderë të krijuar ndërmjet autoriteteve austro-hungareze dhe popullsisë myslimane shqiptare. Për këtë arsye, ai i kërkoi ministrit të Punëve të Jashtme që të ndërhynte pranë qeverisë austro-hungareze për largimin e tij nga Shqipëria. Edhe diplomati tjetër i shquar austro-hungarez, Czernin, e konsideronte vazhdimin e pranisë së gjeneralit Trollmann në Shqipëri, “një gjë të keqe e të rëndë”, për faktin se ai kishte instaluar në këtë vend një regjim të njëanshëm, militarist,

²³ Sali Kadria, “Aspekte të gjendjes së nacionalizmit shqiptar gjatë viteve 1916-1918 në zonën e pushtimit austro-hungarez”, në *Studime historike*, nr. 3-4, 2014, botim i Institutit të Historisë, Tiranë: 2015, f. 123; *HHStA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 27-9-925. Raport tepër rezervat i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez Kral, drejtuar kontit Otokar Czernin, Shkodër, 14 tetor 1917.

²⁴ *HHStA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 27-4-440. Letër rezervat nr. 325/rez. e konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez Kral, drejtuar Rapaport, funksionar i lartë në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 1 maj 1917.

²⁵ *Po aty*, Vj. 26-10-1016. Raport i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez Kral, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 20 mars 1916; *po aty*, Vj. 27-9-934. Raport i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez Kral, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 2 dhjetor 1917.

²⁶ *Po aty*, Vj. 27-4-440. Letër rezervat nr. 325/rez. e konsullit të Përgjithshëm Kral, drejtuar Rapaport, funksionar i lartë në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 1 maj 1917.

antipolitik e antishqiptar²⁷. Ky fakt pohohej edhe nga Syrja Bej Vlora, i cili shkruante se I. Trollmann nuk shpëtoi pa u prekur nga propaganda kundër shqiptarëve myslimanë. Prandaj, viktimat e para të këtyre mendimeve të mbrapshta u bënë këta të fundit²⁸. Informacionet e mbledhura nga burime të ndryshme diplomatike e shtynë Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë në përfundimin se, oficerët austro-hungarezë kishin një përbuzje të thellë për shqiptarët dhe veçanërisht për ata myslimanë. Madje, në mënyrë paradoksale një pjesë e oficerëve austro-hungarezë ëndërronte për kthimin e shqiptarëve myslimanë në të krishterë²⁹.

Marrëdhëniet ndërfitare mes shqiptarëve myslimanë dhe atyre katolikë, por edhe midis autoriteteve civile dhe ushtarake u acaruan edhe më shumë në pranverë të vitit 1918. Më 1 mars 1918, në derën e xhamisë kryesore të qytetit të Shkodrës u gjet një derr i therur, me gjakun e të cilit ishte lyer pragu i derës së saj. Drejtuesit ushtarakë austro-hungarezë penguan hetimet për gjetjen e fajtorëve që organizuan provokimin e besimtarëve myslimanë në një prej xhamive kryesore të këtij qyteti. Ndaj këtij akti provokues, Këshilli i Naltë i Sheriatit të Shqipërisë [në këtë dokument shkruhet Këshilli i Myftinisë, në të tjera gjendet me emrin Gjyqi i Naltë i Sheriatit – S. K.] përmes Myftiut të Përgjithshëm, Vehbi Dibra u shpreh se “popullata muhamedane në të ardhmen, edhe në rastet e teprimeve më të këqija do të përdorë mjete mbrojtje që i përgjigjen qytetërimit. Por marrim guximin të deklarojmë se, po qe se fajtorët nuk do të dënohen rreptë...popullata muhamedane do ta konsiderojë këtë gjë si një dëshmi se të drejtat e saj fetare të shënjta nuk gëzojnë mbrojtje dhe se ne, këshilli i lartë, do të konsiderohemi si të pa aftë të përmbushim detyrat tona të shenjta fetare”. Këshilli i Myftinisë, Shkodër lutej që të gjendeshin “fajtorët e këtij krimi të pështirë e më pastaj për të ndaluar të tilla ngjarje, si dhe drejtuesve klerikal përkatës t’u jepej një këshillim i mirë se masat e nevojshme u morën në këtë drejtim”³⁰.

²⁷ *Po aty*, Vj. 27-7-754. Telegram tepër sekret nr. 13569 i C (Czernin), drejtuar konsullit Kral në Shkodër, datë 24 dhjetor 1917.

²⁸ S. Vlora, *Kujtime – Nga fundi i sundimit osman në Luftën e Vlorës*, f. 158.

²⁹ *HHSStA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 28-6-647. Deklaratë (?) lidhur me çështjen e vendosjes së një qeverie të përgjithshme ushtarake të Shqipërisë, 12 janar 1918.

³⁰ *Po aty*, Vj. 28-7-794. Artikulli i revistës së përmuajshme “Zoja e Shkodrës drita e Shqypnis”, korrik 1918, prej kryemyftiut Vehbi [Dibra], Shkodër, 3 mars 1918.

Komisari civil Kral akuzonte drejtuesit e lartë ushtarakë austro-hungarezë në Shqipëri se kishin zvarritur hetimet e këtij incidenti të rëndë, i cili mund të shkaktonte trazira të brendshme civile. Krahas këtij zhvillimi, drejtuesit e lartë të ushtrisë austro-hungareze me sa duket ishin vënë në dijeni lidhur me kërkesën e Kral-it për largimin e gjeneralit I. Trollmann. Për arsytet e mësipërme, komanda e lartë e ushtrisë austro-hungareze filloi ta akuzonte Komisarin civil Kral se ai “nuk ishte një njeri i mirë, i cili përpiqej për të fituar besimin e plotë të komandantit më të lartë”. Madje, drejtuesit e lartë ushtarakë mendonin se Kral kishte bërë edhe gabime, siç ishin: “Zbatimi shumë i shpejtë i reformave të ndryshme dhe shpesh të papërpunuara” në Shqipëri si dhe “favorizimi i disa grupeve shoqërore dhe i personave të këtyre grupeve”. Ata theksonin se këto masa kishin “shkaktuar urrejtjen e papajtueshme të klerit katolik si dhe zemërimin e të gjithë oficerëve të korpusit” ndaj tij. Për rrjedhojë, drejtuesit ushtarakë mendonin se Kral nuk gëzonte simpatinë e shqiptarëve dhe veçanërisht të udhëheqësve të tyre³¹. Duke parë akuzat dhe urrejtjen e krijuar në mesin e drejtuesve të qarqeve ushtarake, Kral kërkoi vetë dorëheqjen e tij nga detyra e Komisarit të Përgjithshëm Civil në Shqipëri. Mirëpo, ministri i Punëve të Jashtme i kërkoi atij që të vazhdonte të mbante detyrën e ngarkuar³².

Më 11 qershor 1918, Kryekomanda e ushtrisë dhe shefi i Shtabit i ushtrisë austro-hungareze i shkruanin ministrit të Punëve të Jashtme Stefan von Burian, se me propozimin e komandantit të Korpusit XIX dhe gjeneralit të atashuar pranë shtabit të trupave austro-hungareze në Shqipëri, mbështetur në arsye personale dhe disiplinore kërkohej që të realizohej sa më parë shkarkimi nga detyra i Kral, komisarit të Përgjithshëm Civil në Shqipëri. Kryekomanda e ushtrisë austro-hungareze kërkonte që funksionet e detyrës së Komisarit civil në Shqipëri të ndaheshin prej atyre të përfaqësuesit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe ky funksion të vendosej nën vartësinë e Korpuskomandës të ushtrisë austro-hungareze në Shqipëri, i cili do të ishte përgjegjës për administratën civile në këtë vend. Në të kundërt, kërkohej që administrata e Shqipërisë të shkëputej prej Korpuskomandës XIX dhe të varej

³¹ *Po aty*, Vj. 28-6-674. Shkresë konfidenciale e Komandës eprorë të armatës ushtarake Perandorake dhe Mbretërore, për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, 14 maj 1918.

³² *Po aty*, Vj. 28-8-833. Telegram shifër i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez Kral, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 10 maj 1918.

ekskluzivisht prej organeve civile nën drejtimin dhe përgjegjësinë direkte të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Perandorisë Austro-Hungareze³³. Në këto rrethana, konsulli i Përgjithshëm Kral kërkoi për herë të dytë, dorëheqjen e tij nga detyra e komisarit provincial civil³⁴.

Drejtimesit e ushtrisë austro-hungareze si gjenerali Trollmann, feldmareshall-leitnanti Shnehen, koloneli von Lustig dhe koloneli Juha shpreheshin kundër popullsisë myslimane shqiptare dhe Komisarit civil A. Kral, të cilin e konsideronin si mbështetës të shqiptarëve myslimanë. Në dy raporte që A. Kral i drejtoi ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, ai përpiqej të sqaronte marrëdhëniet midis popullsisë myslimane dhe katolike shqiptare si dhe qëndrimin e mbajtur nga autoritetet drejtuese ushtarake në Shqipëri. Në raportin e datës 20 qershor 1918, Kral shprehej me këto fjalë: “Më duhet të shënoj përbuzjen e tij [të feldmareshall-leitnant Shnehen – S. K.] të thellë që ka për myslimanët, fenë, doket dhe zakonet e tyre, gjë të cilën, ai e shfaq me fjalë e madje me anë vendimesh dhe me sjelljen e tij. ...Ai nxori pengesa që të bëhej një hetim i imtë [për incidentin e varjes së derrit në derën e xhamisë – S. K.], i cili do të çonte në një ndëshkim shembullor të fajtorit që kërkohet me urgjencë prej popullsisë”. Mirëpo, përkundër kësaj kërkese, ky drejtues i lartë ushtarak vuri mbi akt shënimin: “Në esencë është mjaft për t’u përshëndetur në qoftë se myslimanët kthehen në të krishterë”. Duke kundërshtuar qëndrimin e mësipërm të drejtuesve të lartë ushtarakë, Kral-i shkruante se ata harronin faktin që “këto veprime bëheshin në një vend të banuar nga një popull, i cili për nga numri kishte shtatë herë më tepër myslimanë se sa të krishterë [katolikë – S. K.] dhe në të cilin qetësia dhe prosperiteti vareshin vetëm prej paqes midis të dy feve”³⁵.

Në raportin tjetër të datës 1 korrik 1918, Komisari civil Kral përpiqej të analizonte raportet ndërfitare mes popullsisë myslimane dhe asaj katolike në Shqipëri. Ai shprehej se kishte një periudhë kohe që në mesin e popullsisë shqiptare myslimane ishin shfaqur shenja pakënaqësie si dhe

³³ *Po aty*, Vj. 28-6-674. Shkresë konfidenciale e Komandës eprorë të armatës ushtarake Perandorake dhe Mbretërore, për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, 14 maj 1918; *po aty*, Vj. 28-2-261. Shkresë nr. 318.295/A e Kryekomandës së ushtrisë dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë austro-hungareze, drejtuar Stefan Burian von Rajeç, ministër i Punëve të Jashtme në Vjenë, A. O. K., 11 qershor 1918.

³⁴ *Po aty*, Vj. 28-2-256. Raport i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez Kral, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 20 qershor 1918.

³⁵ *Po aty*.

një mosbesim për paanshmërinë e autoriteteve ushtarake austro-hungareze në Shqipëri. Fillimisht, kjo gjendje u shkaktua nga disa fjalë të përhapura në mesin e shqiptarëve se kinse Austro-Hungaria ishte një fuqi e madhe katolike. Kral-i pranonte se “që nga pushtimi ynë, për besimin katolik... [kishte preferenca? - S. K.], e cila tani sipas rregullores ushtarake bëhet publikisht, me një mënyrë krejt zyrtare e në rastet festive me një farë pompoziteti”³⁶.

Në përpjekje për të gjetur shkaqet e shfaqjes së këtij rivaliteti midis popullsisë katolike dhe asaj myslimane në Shqipëri, diplomati i njohur austro-hungarez shkruante se “mund të pranojmë lehtësisht se kleri katolik shkodran me krenarinë e tij që nganjëherë e ekzagjeron këtë situatë...shfaqet me një farë ndjenje fitoreje...”³⁷. Ndryshe nga më parë, pas okupimit austro-hungarez vihej re se në rastet ceremoniale të festave, përparësia e klerit mysliman i kaloi klerit katolik dhe në kremtimet solemne që bëheshin në institucionet fetare [xhami dhe kisha], zyrtarët shkonin më parë në katedralen katolike dhe pastaj në xhami. Kjo rrethanë, sqaronte Kral-i, lidhej me rolin e rëndësishëm që kishte kisha katolike në Monarkinë Austro-Hungareze. Për të shmangur grindjet mes klerit dhe komuniteteve të ndryshme fetare në lidhje me faktin se cili besim fetar duhej të kishte përparësi, autoritetet austro-hungareze kishin vendosur pak kohë më parë që në rastet e pritjeve zyrtare, kleri i të gjitha besimeve duhej të paraqitej para komandantit të Korpusit XIX. Mirëpo, Komisari civil Kral pohonte se qysh në rastin e parë, nga ana e ipeshkëvijve katolikë u shkaktua një stuhi e tillë zemërimi, sa u desh që të hiqej dorë nga pritja ceremoniale e përbashkët. Si shkak tjetër për shfaqjen e ndjenjës së rivalitetit mes dy komuniteteve fetare shqiptare shërbeu fillimi i ndërtimit dhe i restaurimit të kishave katolike dhe lënia pas dore e ndërtesave të fesë myslimane. Sipas këndvështrimit të Kral-it, popullsia myslimane e Shkodrës u shqetësua nga mënyra e bujshme me të cilën argjipeshkvi katolik i këtij qyteti vendosi fillimin e ndërtimit të një kisha të madhe peligrinazhi pranë lumit Buna në Shkodër. Duke e parë nga pikëpamja politike, konsulli Kral e quante pa vend ekzagjerimin që u shfaq në këtë rast nga ana e argjipeshkvit, përderisa nuk ishte vendosur ende që të bëhej diçka edhe për ndërtimin e xhamive të dëmtuara që i

³⁶ *Po aty*, Vj. 28-7-789. Raport tepër konfidencial nr. 165/pol. i Kral-it, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 1 korrik 1918.

³⁷ *Po aty*.

përkisnin popullsisë myslimane shqiptare. Gjithashtu, ai mendonte se nuk ishte e drejtë që autoritetet ushtarake kishin lejuar fillimin e ndërtimit të kishave në Shkodër, Berat dhe Elbasan, thjesht “për t’u bërë qejfin katolikëve”. Ndërtimi i tyre kishte ngjallur pakënaqësinë e popullsisë muhamedane të dy qyteteve të fundit, sepse vendi i zgjedhur për kishat ishte në afërsi të xhamive ose mbi pronën e vakëfit. Për më tepër, theksonte Kral-i, ndërtimi i kishave bëhej në këto dy qytete, kur dihej qartë se në Elbasan dhe Berat nuk kishte banorë katolikë. Pas ndryshimit të drejtimit të komandës austro-hungareze, këto dy projekte u anuluan³⁸.

Edhe autoritetet ushtarake austro-hungareze në Shqipëri pranin faktin se vendosja e gurit të themelit të kishës së peligrinazhit pranë lumit Buna, shërbeu si shkak për lindjen e fërkimeve midis dy grupeve fetare të popullsisë së Shkodrës dhe se ato po bëheshin gjithnjë e më të thella. Frika e shqiptarëve myslimanë se mos bëheshin një pjesë e shtypur e popullsisë, shpreheshin drejtuesit ushtarakë të komandës së qarkut Shkodër, kishte ngjallur një lloj propagande panislame që synonte bashkimin e të gjithë shqiptarëve myslimanë kundër elementit katolik, i cili pretendohet se ishte i preferuar nga autoritetet austro-hungareze³⁹.

Gjatë verës së vitit 1918, ndërmjet komandës së trupave austro-hungareze dhe Komisarit civil Kral vijoi që të kishte divergjenca të thella⁴⁰. Për t’i dhënë fund kësaj situatë, në fund të muajit shtator 1918, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Kryekomanda e ushtrisë austro-hungareze ranë dakord që detyra e Komisarit Provincial Civil në Shqipëri të ndahej nga ajo e përfaqësuesit të Ministrisë së Punëve të Jashtme në këtë vend. Në detyrën e konsullit të Përgjithshëm u caktua baroni Bornemizha ndërsa në atë të Komisarit civil vazhdoi të ishte A. Kral⁴¹.

³⁸ *Po aty*.

³⁹ *Po aty*, Vj. 27-9-926. Aneks i raportit nr. 193/pol. të Komandës së Bezirkut I, Shkodër, 14 tetor 1917.

⁴⁰ *Po aty*, Vj. 28-2- 243. Depeshë telefonike Nr. 236 e ministrit të Jashtëm Burian, drejtuar kontit Trautmansdorff në Baden, Vjenë, 29 korrik 1918.

⁴¹ *Po aty*, Vj. 28-2-228. Telegram shifër i ministrit të Jashtëm Burian, drejtuar konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez, baronit Bornemizha, Vjenë, 27 shtator 1918; *po aty*, Vj. 28-2-228. Shkresë e ministrit të Jashtëm Burian, drejtuar [?], Vjenë, 28 shtator 1918.

Qëndrimi i autoriteteve ushtarake dhe civile austro-hungareze ndaj klerit e institucioneve fetare myslimane në Shqipëri

Gjatë viteve të para pas Shpalljes së Pavarësisë, nostalgjia e shqiptarëve myslimanë për Kalifatin e Stambollit mbeti mjaft e fortë. Pas okupimit të Shqipërisë nga trupat austro-hungareze, kleri mysliman në Shqipëri vazhdoi veprimtarinë e tij njësoj si më parë, por pa një definicion të qartë. Simpatia e shqiptarëve për Kalifatin osman filloi të zbehej pas pushtimit të Shqipërisë nga ushtritë ndërluftuese evropiane gjatë Luftës së Parë Botërore. Në aspektin fetar, administrata ushtarake austro-hungareze la gjurmë të thella në viset shqiptare që ishin nën okupimin e saj pasi ajo mbështeti reformat shekullore, duke zbehur ndikimin e fuqishëm osman në mesin e shqiptarëve myslimanë⁴². Komisari civil Kral raportonte se kleri mysliman kishte ruajtur mëvetësinë nga Sheh-Ul-Islami në Stamboll dhe në krye të tij qëndronte një kryemyfti, i cili ishte drejtuesi i të gjithë ulemave dhe i administratës së Sheriatit në Shqipëri. Në vijim të pasqyrimin të gjendjes së fesë islame në territorin e Shqipërisë të okupuar nga trupat austro-hungareze, Kral-i shprehej se, përderisa ky vend ishte një shtet autonom dhe jo një territor i pushtuar, ai mund të pretendonte të kishte kryetarin e vet të fesë islame⁴³.

Mënyra se si ia parashtronte Vjenës çështjen e fesë islame në Shqipëri, dëshmonte se Komisari civil Kral e konsideronte shkëputjen e institucioneve të këtij besimi si një fakt të kryer, të cilin e kishte gjetur të realizuar në praktikë, pas shkëputjes së Shqipërisë nga Perandoria Osmane gjatë viteve 1912-1916. Mirëpo, para tij vijonte të mbetej shqetësuese zgjidhja e dy çështjeve të rëndësishme. Ai konsideronte si problem kryesor sigurimin e një miratimi “de jure” nga Sheh-Ul-Islami (Sheikh al-Islam) në Stamboll për Myftininë e Shqipërisë, në rastin më të mirë ose në pamundësi të miratimit të saj atje, të kërkohej mbështetja e Myftinisë së Përgjithshme të Bosnjë-Hercegovinës për mbështetjen dhe konsolidimin e strukturave të fesë islame në Shqipëri. Kujtojmë se Reis-Ul-Ulema (Ra'is al-Ulama) [Myftiut të Madh ose Kryemyftiut – S. K.] e

⁴² Olsi Jazexhi, “Albania”, në *Islamic leadership in the European lands of the former Ottoman and Russian Empires: legacy, challenges and change*, Edited by Egdūnas Račius, Antonina Zhelvazkova, Leiden/Boston: “Koninklijke Brill NV”, 2018, p. 47.

⁴³ H. Bello, *Marrëdhëniet shqiptaro-turke...*, f. 213-214; *HHStA, PA, A*, në *AIH, Vj.* 26-1-172. Raport i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez A. Kral, mbi çështjet e fesë islame në Shqipëri, Shkodër, 25 korrik 1916.

Bosnjë-Hercegovinës ishte krijuar më 15 dhjetor 1882, me ndihmën e Benjamin von Kallay-it⁴⁴, i cili në atë periudhë mbante detyrën e guvernatorit austro-hungarez në këtë vend*.

Më 11 gusht 1916, Kral-i i paraqiti Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë projektin, sipas të cilit parashikohej që në viset shqiptare që ndodheshin nën okupimin e Austro-Hungarisë të emërohej një kryemyfti vendas për të drejtuar çështjet e fesë myslimane. Për këtë qëllim, ai i sugjeronte Vjenës që edhe në rastin shqiptar të veprohej sipas mënyrës së krijimit të Reis-Ul-Ulema-së, të Bosnjës, pas okupimit austro-hungarez të këtij vendi në vitin 1878. Madje, zëvendësshefi i ushtrisë austro-hungareze kishte propozuar që të ftohej në Shqipëri, Reis-ul-Ulema i Sarajevës së bashku me disa hoxhallarë “shëtitës” boshnjakë, që t’i këshillonin shqiptarët myslimanë për mënyrën se si duhej të silleshin me autoritetet ushtarake austro-hungareze. Komisari civil A. Kral e hodhi poshtë sugjerimin e fundit të paraqitur nga qarqet drejtuese ushtarake austro-hungareze në Shqipëri, por pavarësisht hezitimit të tij, drejtuesit ushtarakë e nxitën atë që t’i kërkonte diplomacisë vjeneze ndërhyrjen e saj pranë qeverisë osmane, me qëllim që të sigurohej një lloj miratimi nga Sheh-Ul-Islami në Stamboll për emërimin e një kryemyftiu vendas në Shqipëri⁴⁵.

⁴⁴ Fikret Karčić, “The Office of Ra'is al-Ulama' Among the Bosniaks (Bosnian Muslims)”, në *Intellectual Discourse*, vol 5, No. 2, published by International Islamic University Malaysia, Kuala Lumpur, Malaysia: 1997, p. 113; Fikret Karčić, *The Bosniaks and the Challenge of Modernity – Late Ottoman and Hapsburg Times*, Sarajevo: el-Kalem, 1999, pp. 123-139; Alexandre Popovic, *L'islam balkanique. Les musulmans du sud-est européen dans la période post-ottomane*, Wiesbaden: Harrassowitz, 1986, pp. 273-278; Muhamed Mufaku al-Arnaut, “Islam and Muslims in Bosnia 1878-1918: Two Hijras and Two Fatwas”, në *Journal of Islamic Studies*, vol. 2, Oxford of University Press: 1994, pp. 242-253.

* Benjamin von Kallay kishte emëruar Reis-Ul-Ulema-në e parë (Drejtuesi i ulemave ose dijetarëve të fesë islame) të Bosnjës, i cili ndihmohej nga Ulema medzlis (Këshilli i dijetarëve) i përbërë nga katër persona dhe më vonë u ngrit edhe Sabori i Vakëf Mearif (Kuvendi i Vakëfeve). Në këtë mënyrë u krijua udhëheqja fetare kombëtare e boshnjakëve, e cila u shkëput nga qendra fetare e Sheh-Ul-Islamit në Stamboll.

⁴⁵ S. Kadria, “Aspekte të gjendjes së nacionalizmit shqiptar gjatë viteve 1916-1918 në zonën e pushtimit austro-hungarez”, në *Studime historike*, nr. 3-4, Tiranë: 2014, f. 123; *HHSStA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 26-1-173. Raport i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez Kral, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 11 gusht 1916; O. Jazexhi, “Albania”, në *Islamic leadership in the European lands of the former Ottoman and Russian Empires...*, p. 47.

Në përgjigjen e tij, ministri i Punëve të Jashtme, Stefan von Burian, mbështeti refuzimin e Komisarit civil Kral ndaj idesë së ardhjes në Shqipëri të hoxhallarëve “shëtitës” të parashtruar nga ushtarakët. Në të njëjtën kohë, ai kundërshtoi edhe sugjerimin e diplomatit austro-hungarez në Shqipëri për marrjen e një lloj miratimi nga Sheh-Ul-Islami i Stambollit për emërimin e kryemyftiut të Shqipërisë. Sipas tij, pozita e fesë myslimane në Shqipëri nuk ishte e ngjashme me atë të Bosnjës, por me atë të vendeve krejtësisht të pavarura. Kryediplomati austro-hungarez sqaronte se vendimi për krijimin e Reis-ul-Ulemasë së Sarajevës nga Sheh-Ul-Islami i Stambollit, ishte pjesë përbërëse e kushteve nën të cilat Perandoria Osmane pranoi aneksimin e Bosnjë-Hercegovinës nga Austro-Hungaria në vitin 1909. Ndryshe nga historia e Bosnjë-Hercegovinës, në rastin e Shqipërisë, shkëputja e saj nga Perandoria Osmane u realizua sipas vendimeve ndërkombëtare të vitit 1913, ku Shqipëria ishte një vend krejtësisht dhe përgjithnjë i pavarur nga Perandoria Osmane⁴⁶.

Mbështetur në argumentin e mësipërm, Vjena fillimisht nuk mbështeti idenë e emërimit në Shqipëri të një kryemyftiu vendas. Ajo u justifikua me argumentin se emërimi nga autoritetet ushtarake austro-hungareze të kryemyftiut mysliman shqiptar nuk mund të realizohej, pasi okupimi austro-hungarez i Shqipërisë kishte karakter provizor. Në të vërtetë, zyrtarizimi i Myftinisë së Shqipërisë zvarritej qëllimisht pasi drejtuesit e qeverisë austro-hungareze mendonin se realizimi i këtij projekti mund të ishte në kundërshtim me interesat politike të Austro-Hungarisë në këtë vend dhe në raport me shtetin aleat osman, njëkohësisht ai mund të mos ishte në përputhje edhe me interesat e Shqipërisë⁴⁷.

Me sa duket, në Vjenë kishte dyshime nëse zyrtarizimi i Myftinisë së Shqipërisë ishte hapi i duhur. Drejtuesit e diplomacisë austro-hungareze menduan se një hap i pamenduar, mund t’i hapte telashe të mëdha Vjenës zyrtare. Ngritja e strukturës së myftinisë në këtë vend, mund të konsiderohej nga shqiptarët e besimeve të tjera brenda vendit si një hap i njëanshëm i Vjenës në mbështetje të shqiptarëve myslimanë dhe kjo mund të nxiste divergjencat e brendshme fetare. Kjo lëvizje rrezikonte të krijonte në Shqipëri një qendër drejtuese të rezistencës së shqiptarëve

⁴⁶ *HHStA, PA, A, në AIH, Vj. 26-1-173*. Telegram shifër i ministrit të Punëve të Jashtme Burian, drejtuar Kral-it, përfaqësuesit të Përgjithshëm austro-hungarez në Shkodër, Vjenë, 22 gusht 1916.

⁴⁷ *Po aty*.

myslimanë kundër okupimit austro-hungarez. Ndërhyrja austro-hungareze në Stamboll, mund të shkaktonte përplasje politike me qeverinë osmane, pasi drejtuesit osmanë do të kundërshtonin synimet e Vjenës për të shkëputur shqiptarët myslimanë nga varësia shpirtërore e Sheh-Ul-Islamit të Stambollit. Prandaj, qeveria austro-hungareze nuk mund të rrezikonte humbjen e një aleateje ushtarake me vlerë të bllokut austro-gjerman, për një projekt i cili nuk sillte ndonjë përfitim të madh për Austro-Hungarinë. Gjithashtu, kjo lëvizje politike e Vjenës mund të nxiste më tepër propagandën dhe ndërhyrjen e qeverisë xhonturke në Shqipëri, pasi një pjesë e mirë e drejtuesve osmanë ende nuk kishin hequr dorë nga prirja paternaliste e shtetit osman ndaj këtij vendi të vogël apo nga ideja e caktimit të një princi mysliman turk në krye të fronit të Shqipërisë.

Qëndrimi i ngurtë i qeverisë austro-hungareze kundrejt projektit politik për mëvetësinë e klerit mysliman shqiptar filloi të ndryshonte brenda një kohe të shkurtër. Për të shmangur ndërhyrjen politike dhe propagandën fetare të xhonturqve në mesin e shqiptarëve myslimanë, drejtuesit e qeverisë austro-hungareze me sa duket, menduan se ishte më e përshtatshme që të ndërmerreshin hapa konkrete në drejtim të mëvetësisë dhe konsolidimit të pozitës së klerit mysliman shqiptar. Me urdhër të kryekomandës ushtarake austro-hungareze në Shqipëri, në tetor të vitit 1916 në Shkodër u ngrit Gjyqi i Naltë i Sherisë (Sheriatit) nën drejtimin e myftiut Vehbi Efendi Dibra, i cili kishte në përbërje dy anëtarë, si kryesekretarin dhe dy shkrues⁴⁸. Syrja Bej Vlora sqaron se çështjet e Sheriatit iu besuan një këshilli të lartë të drejtuar nga Vehbi Efendi Dibra me anëtarë Vesel Efendi Libohovën dhe Hafëz Ali Efendi Korçën⁴⁹. Kral-i raportonte se gjatë kësaj periudhe ishin marrë masa të rëndësishme në favor të popullsisë myslimane, si: riorganizimi i gjykatave të Sheriatit, emërimi i kryemyftiut dhe formimi i një gjykate që merrej me të gjitha problemet juridiko-fetare⁵⁰.

Në muajin qershor 1917, komanda e trupave austro-hungareze në Shqipëri, mbështetur në marrëveshjen e arritur ndërmjet Drejtorisë së

⁴⁸ H. Bello, *Marrëdhëniet shqiptaro-turke...*, f. 215; O. Jazexhi, "Albania", në *Islamic leadership in the European lands of the former Ottoman and Russian Empires...*, p. 48.

⁴⁹ S. Vlora, *Kujtime – Nga fundi i sundimit osman në Luftën e Vlorës ...*, f. 161.

⁵⁰ *HHStA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 26-18-1802. Raport i Komisarit civil Kral, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 10 tetor 1916.

Përgjithshme të Arsimit e Fesë dhe Kryemyftiut, vendosi që mësimi i fesë islame të zhvillohej në të gjithë shkollat e vendit⁵¹. Më 25 qershor 1917, komanda ushtarake austro-hungareze me qendër në Shkodër miratoi “Rregulloren provizore të organizimit të çështjeve të Sheriatit në Shqipëri”, e cila përmbante 43 nene⁵². Në këtë kuadër, Myftiu i Përgjithshëm Vehbi Dibra u drejtoi një urdhër-qarkore të gjithë sherive të qarqeve të vendit. Në të kërkohej që lutjet të mos bëheshin në turqisht, por në gjuhën shqipe si dhe sulltani të mos përmendej më si mbret i Shqipërisë, përderisa ajo ishte një shtet i pavarur, i cili nuk ndodhej nën varësinë e shtetit osman⁵³.

Komanda ushtarake austro-hungareze në Shqipëri, botoi një rregullore me emërtimin: “*Parashkresë e përkohshme mbi të dhanunt e nëpunshvet të Vakufit në Shqipni*”, e cila mban datën 27 korrik 1917. Në të pasqyrohej procedura e emërimeve të nëpunësve të institucioneve të vakëfit në Shqipëri⁵⁴. Nga shqyrtimi i kësaj rregulloreje rezulton se, institucionet më të larta që merreshin me çështjet fetare dhe pasurinë e institucioneve të fesë islame në Shqipëri ishin Zyra e Kryemyftiut dhe Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfit. Sipas rregullores, të gjithë nëpunësitë e vakufit ndaheshin zyrtarisht në dy pjesë: 1. Shërbime të besimit dhe të diturisë (Xhahati dimyje ve ilmije)*; 2. Shërbime ekonomike (Idare

⁵¹ *Po aty*, Vj. 27-1-135. Aneks i raportit të Korpuskomandës nr. 2325/I të Shkodrës, Shkodër, 17 qershor 1917.

⁵² *Po aty*, Vj. 27-63. Rregullore provizore e organizimit të çështjeve të Sheriatit në Shqipëri, Shkodër, 25 qershor 1917, cituar sipas H. Bello, *Marrëdhëniet shqiptaro-turke...*, f. 215.

⁵³ H. Bello, *Marrëdhëniet shqiptaro-turke...*, f. 216; Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 482, viti (më tej: V.) 1917, dosja (më tej: D.) 39, fl. 1. Urdhër i Kryemyftiut të Përgjithshëm Haxhi Vehbi Dibra, drejtuar sherive të vendit, datë 26 qershor 1917.

⁵⁴ *Parashkresë e përkohshme mbi të dhanunt e nëpunshvet të Vakufit në Shqipni*, nxjerrë nga Ma e Nalta Komandë mb. e r. në Shqipni, E. V. No. 1138/III. ex 1917, Shkodër: Nikaj 1917.

* Nëpunësit e shërbimit të besimit apo të diturisë së fesë islame ishin: Hatibi (imami, i cili drejton ceremonitë fetare më të rëndësishme), imami, vaizi (predikuesi), muezzini (personi që i udhëheq dhe u bën thirrje besimtarëve nga minareja që të vijnë për falje në xhami), muderrisi, mualimi (mësues), shehu (i pari i teqës), muxhevid (është personi, i cili lexon Kuranin, librin e shenjtë të fesë islame sipas rregullave të texhvidit), devirhani (është personi i punësuar në një vakëf, i cili ka për detyrë të lexojë vetëm Kuranin dhe ta recitojë atë sipas një mënyre të veçantë), xhuz-hani (besimtar që reciton një xhuz ose pjesë të Kuranit për një periudhë të caktuar p.sh. për një muaj. Kurani ka gjithsej 30 xhuze ose pjesë unitare dhe një xhuz ose pjesë

xhietetleri), të cilat kishin të bënin me zhvillimin, kujdesin dhe mbikëqyrjen e vakëfeve* .

Në mbështetje të këtij urdhri, parashikohej që të gjithë emërimet e nëpunësve të vakëfeve do të bëheshin vetëm me anë të vendimeve ose dekreteve (teskere, tevxhihname). Nëpunësit e institucioneve fetare që emëroheshin me vendime, do të paguheshin nga të ardhurat që siguroheshin nga vjelja e taksave të vendit përmes Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfit nën drejtimin e komandës austro-hungareze në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Zyrën e Kryemyftiut (Mexhlisi Ilmyje, Gjyqi i Lartë i Sheriatit). Për të gjitha rastet e tjera thuhej në rregullore, ishin të vlershme këto parime. Zyra e Kryemyftiut në marrëveshje me Drejtorinë e Përgjithshme të Vakëfit kishte të drejtë të emëronte nëpunësit e zyrave që kryenin shërbimet fetare e të diturisë. Akti i emërimit zyrtar për nëpunësit e zyrave ekonomike si dhe dorëzimi i dekreteve për këto shërbime realizohej nga Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfit në marrëveshje me Zyrën e Kryemyftiut. Muteveli-u [administratori i një vakëfi – S. K.] kishte të drejtën e emërimit të një punonjësi në ndonjë shërbim vakëfi jo aq të rëndësishëm, por kjo ndodhte pasi ai merrte vendimin (letërvakfije ose vasijetname), ndërkohë që dorëzimi i dekretit i përkiste sërish Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfit.

Vendimi për punësimin e një nëpunësi që merrej me çështjet e besimit ose të diturisë të fesë islame i përkiste Zyrës së Kryemyftiut, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfit ishte ngarkuar me detyrën që të provonte aftësinë e nëpunësve të cilët merreshin me çështjet ekonomike të institucioneve fetare. Aftësia për një vend pune duhej të dëshmohej me anë të dëftesës që merrej nga kandidati pasi të jepte një provim të vlefshëm zyrtar, ose me anë të ndonjë vërtetimi tjetër që dëshmonte një veprimtari pozitive të kandidatit gjatë shumë viteve në atë degë shërbimi. Në qoftë se mungonin vërtetime të tilla, atëherë kërkuesi i atij pozicioni pune, duhej t'i nënshtrohej një provimi përpara Zyrës së Kryemyftiut. Në

përbëhet nga 20 faqe Kurani), kahr-ı ashır (lexuesi i dhjetë sureve të fundit të Kuranit[?]), etj.

* Nëpunësit që merreshin me shërbimet ekonomike në institucionet që ishin në funksion të fesë islame ishin: Muteveliu (mbarështruesi - administratori), naziri (inspektori), qatibi (sekretari), xhabiu (mbledhësi i detyrimeve, tahsildari), ferrashi (shërbëtori i xhamisë), nakibi (kontrollori i gjellëtores), shehu i imaretit (kryetari i gjellëtores), habbasi (bukëpjekësi), veqilharxhi (rregulluesi i mjeteve të ushqimit), mbikëqyrësi i magazinës, kajimi (shërbëtori), türbedari (kujdestar i varr/it/eve të shenjt/ë/a), su-jollxhiu (roja i rremave të ujit).

rast se kandidati nuk kërkonte detyrat e shehut, vaizit ose myderrizit, provimi i tij i ngarkohej një komisioni të përbërë prej një Gjyqtari të Sheriatit dhe dy anëtarëve të tjerë që do të caktoheshin nga Zyra e Kryemyftiut. Ky komision provimi merrte vendimin mbi aftësinë e kërkuarit mbështetur në shumicën e votave. Vendimi përfundimtar mbi aftësinë e aplikantëve që kërkonin të punësoheshin në shërbimet ekonomike merrej nga Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfit. Kjo drejtori mund t'u ngarkonte marrjen e vendimit edhe komisioneve të Vakëfit. Në rregullore parashikoheshin edhe rastet kur provimi zhvillohej përpara një komisioni të caktuar nga Zyra e Kryemyftiut apo nga Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfit dhe ndodhte që njëri prej këtyre institucioneve të mos e pranonte vendimin e dhënë prej komisionit të provimit mbi aftësinë e aplikantit. Për këto lloj rastesh, parashikohej që secili prej institucioneve të mësipërme ishte i lirë të ftonte aplikantin në një provim të ri dhe të jepte vendimin përfundimtar sipas rezultatit të këtij provimi. Në qoftë se për një detyrë të shërbimit fetar mysliman kandidonin dy apo më shumë aplikantë, atëherë çështja i paraqitej Gjyqit të Sheriatit, i cili ishte organ i specializuar për gjykime të kësaj natyre. Pala që nuk pranonte vendimin e dhënë nga Gjyqi i Sheriatit mbi këtë çështje, ishte e lirë ta apelonte çështjen brenda 14 ditësh në Gjyqin e Naltë të Sheriatit. Kundër vendimit të këtij organi nuk mund të apelohej më, prandaj ai duhej të merrej për themel nga zyra emëruese e kandidatit.

Kërkesat për punësim në vendet vakante në institucionet e vakëfit, duhej t'i drejtoheshin kryesisht Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfit. Por, ato mund t'u paraqiteshin edhe komisioneve të Vakëfit ose gjyqeve të Sheriatit dhe këto të fundit do t'i dërgoheshin Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfit. Për këto raste, kjo drejtori duhej të merrte vendim vetë ose nëse kishte ankesa detyrohej t'ia paraqiste rastin Gjyqit të Naltë të Sheriatit ose Komandës së Lartë së trupave austro-hungareze në Shqipëri.

Në rastet kur administratorët e vakëfeve kishin të drejtë të emëronin ndonjë nëpunës në vakëfe të vogla, ata ishin të detyruar të mbanin parasysh kriteret e vendimeve të shpallura si dhe këtë rregullore, për mënyrën e caktimit në detyrë të nëpunësve të vakëfit. Administratorët e vakëfeve ishin të detyruar që këto emërime t'ia bënin të ditur Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfit brenda një afati kohor të shkurtër, në mënyrë

që ky institucion të jepte vendimin e emërimit të nëpunësit si dhe të caktonte masën e taksës që do të paguante i emëruari⁵⁶.

Në vitin 1917, komanda ushtarake austro-hungareze, mbështetur në ligjin osman të datës 9 prill 1873 (10 safar 1290 - sipas kalendarit të vjetër mysliman), botoi “*Urdhënimin mbi të dhânunit e nëpunësivet trashigimtare të Vakufit në Shqipëri*” që mban datën 27 korrik 1917. Ky urdhër parashikonte procedurën që duhej të ndiqej për emërimet e nëpunësve në detyrat fetare të trashëguara, si dhe mënyrën e zgjidhjes së problemeve, për rastet e emërimeve të nëpunësve në vakëfet që funksiononin si institucione më vete (mustekil), për ato të sekuestruara (mazbut), si dhe për rastet e vendeve të punës të mbetura vakante pas vdekjes së njerëzve të shquar (tesarruf)⁵⁷. Sejfi Vllamasi shkruan se gjatë periudhës së okupimit austro-hungarez të Shqipërisë, autoritetet sollën nga Bosnja një specialist për organizimin e institucionit të vakëfeve⁵⁸.

Gjatë vitit 1918, administrata civile austro-hungareze në Shqipëri i kushtoi një rëndësi më të madhe organizimit të institucioneve të klerit si dhe përmirësimit të shërbesave fetare islame. Kjo u realizua përmes rritjes së numrit të personelit, përmirësimit të gjendjes ekonomike si dhe rritjes së nivelit të përgatitjes së imamëve. Duke parë zhvillimin që pësoi gjuha shqipe gjatë dy viteve të fundit në drejtim të përmirësimit të terminologjisë dhe frazeologjisë, si dhe kufizimin e rreptë të përdorimit të gjuhës turke në gjyqet e Sheriatit, më 18 maj 1918, komanda e ushtrisë austro-hungareze në Shqipëri nxori një urdhër në të cilin kërkohet që të gjitha proceset gjyqësore të Sheriatit në këtë vend të kryheshin në gjuhën shqipe⁵⁹.

Pavarësisht këtyre zhvillimeve pozitive që njohu kleri mysliman shqiptar, mbështetur në dokumentet arkivore austro-hungareze, duket se edhe në verën e vitit 1918, drejtuesit e ushtrisë austro-hungareze

⁵⁶ *Po aty*.

⁵⁷ *Urdhënim Mbi të dhânunit e nëpunësivet trashigimtare të Vakufit në Shqipëri*. (Mbas ligjës turke me 10 sefer 1290). Nga mâ e Nalta Komandë mb.e rr.në Shqipëri E. V. No. 1138/ V. ex 1917, Shkodër: Nikaj 1917.

⁵⁸ Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942* (Kujtime dhe vlerësime historike), botim i dytë, Tiranë: Neraida, 2000, f. 132.

⁵⁹ *HHSStA, PA, A, në AIH, Vj. 28-68*. Raport i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez në Shkodër Kral, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 14 qershor 1918; “Gjuha shqype gjuhë zyrtet në gjyqje të Sheriatit - Korpskomanda p. e mb. XIX. E. V. Nr. 3962/III”, në *Posta e Shqypniës*, nr. 56, Shkodër: 29 qershor 1918, f. 4.

parashtruan për herë të dytë kërkesën për përfshirjen e Kryemyftinisë së Shqipërisë në kuadër të Reis-Ul-Ulema-së së Sarajevës. Zëvendës shefi i Shtabit të ushtrisë austro-hungareze me qendër në Shkodër, i kërkonte qeverisë austro-hungareze vendosjen e klerit mysliman shqiptar nën drejtimin e atij boshnjak. Në të njëjtën kohë, ai kërkoi që të ftohej një grup hoxhallarësh shëtitës boshnjakë në Shqipëri. Komisari civil Kral doli kundër propozimit të drejtuesve ushtarakë të Korpusit XIX në Shqipëri, për ardhjen e këtyre hoxhallarëve të Reis-Ul-Ulemasë së Bosnjës në Shqipëri. Ai paraqiti para ushtarakëve austro-hungarezë argumentin se Shqipëria ishte një vend autonom. Prandaj, mbështetur në këtë fakt, ajo nuk duhej trajtuar si një vend i aneksuar nga Monarkia Habsburge. Kral ishte shprehur se shqiptarëve myslimanë mund t'u lejohej lidhja shpirtërore me Sheh-Ul-Islamin e Stambollit, por nuk mund të pranohej që Shqipëria të vihej nën varësinë e drejtuesve të fesë islame të vendeve të tjera ballkanike si Bosnja, statusi politik i së cilës nuk ishte i barabartë me të. Konsulli Kral mendonte se drejtuesit e ushtrisë austro-hungareze në Shqipëri e shihnin këtë lëvizje politike si një masë ndëshkimore ndaj shqiptarëve myslimanë me synim nënshtrimin e tyre ndaj një institucioni fetar të një populli tjetër mysliman⁶⁰.

Për të qartësuar më tepër klerikët myslimanë si dhe për të konsoliduar strukturën hierarkike të klerit në territorin e Shqipërisë që gjendej nën okupimin austro-hungarez, në mesin e muajit shtator 1918, autoritetet austro-hungareze i drejtuan një qarkore të gjithë qarkkomandave të vendit. Me këtë qarkore bëhej e ditur se Gjyqi i Naltë i Sheriatit kishte marrë vendim për organizimin e Sherisë së Shqipërisë. Në këtë dokument, theksohej se, në krye të organizimit të Sherisë në Shqipëri ishte Myftiu i Përgjithshëm. Në varësinë e tij ishin të gjithë klerikët myslimanë, gjyqtarët e Sherisë dhe nëpunësit e tjerë të vakëfeve myslimane. Myftiu i Përgjithshëm ishte autoriteti më i lartë fetar për të gjitha çështjet e myslimanëve si dhe për institucionet e vakëfit e të diturisë së fesë islame. Pranë Myftiut të Përgjithshëm qëndronin si ndihmës dy ulema, të cilët formonin Këshillin e Naltë të Sheriatit. Ky këshill ishte organi më i lartë për çështjet e besimit dhe të gjykimeve të çështjeve që kishin të bënin me fenë islame dhe institucionet fetare të saj.

⁶⁰ *HHStA, PA, A, në AIH, Vj. 28-7-789*. Raport tepër konfidencial i Kral-it, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 1 korrik 1918.

Ai kishte të drejtën e zgjedhjes së klerikëve, mësuesve të fesë islame dhe nëpunësve të tjerë. Sipas rregullores, detyrat e Myftiut të Përgjithshëm, të Këshillit të Naltë të Sherisë, të myfti-kadive, naibëve, vaizëve e nëpunësve të tjerë ishin të përcaktuara qartë. Me anë të kësaj qarkoreje, gjithashtu kërkoheshin që predikimet në xhami të mbaheshin në shqip dhe arabisht dhe ato duhej që t'u përgjigjeshin nevojave të kohës dhe urdhrave të autoriteteve ushtarake e civile. Vendimet gjyqësore të Këshillit të Naltë të Sheriatit duhej të shoqëroheshin me një përmbledhje të shkurtër në gjuhën shqipe⁶¹.

Në vjeshtën e vitit 1918, qeveria austro-hungareze lëshoi disa direktiva për politikën që do të ndiqte në të ardhmen në Shqipëri. Sipas kësaj platforme politike, populli shqiptar duhej të shihej dhe të trajtohej si një komb neutral pro austriak. Në funksion të këtij qëllimi, kërkoheshin që administrata ushtarake në Shqipëri duhej të zbatonte këto orientime në marrëdhëniet me shqiptarët: Të ndaloheshin aktet, të cilat fyenin dhe provokonin njërin apo tjetrin grupim të shqiptarëve, sidomos manifestimet fetare që drejtoheshin kundër një besimi të veçantë. Të gjitha konfesionet fetare në Shqipëri duhej të kishin të drejta të barabarta dhe në këtë drejtim autoritetet ushtarake dhe civile austro-hungareze në Shqipëri nuk duhej të shfaqnin asnjë lloj preference ndaj një besimi fetar në dëm të tjetrit⁶².

Konkluzione:

Nga parashtrimi i mësipërm vihet re se gjatë viteve 1916-1918 autoritetet austro-hungareze ndoqën dy linja qëndrimi ndaj besimeve fetare në Shqipëri. Nga njëra anë, autoritetet ushtarake austro-hungareze e shihnin me përbuzje popullsinë myslimane shqiptare dhe prireshin të mbanin anën e popullsisë katolike. Nga ana tjetër, autoritetet civile dhe në mënyrë të veçantë Komisarari civil Kral u përpoqën të mbanin parasysh raportet fetare brenda vendit, pasi e kishin të qartë se mbajtja e një qëndrimi të njëanshëm në favor të popullsisë dhe klerit katolik shqiptar mund të rrezikonte fillimin e një lufte të brendshme civile, e cila do të

⁶¹ *Po aty*, Vj. 28-70. Qarkore drejtuar të gjithë qarkkomandave mbi vendimin e Gjyqit të Naltë të Sheriatit, Shkodër, 14 qershor 1918.

⁶² *Po aty*, Vj. 28-2-232. Shtojcë e shkresës nr. 4340, Amendamenti. Direktivat politike për administratën e Shqipërisë, 14 shtator 1918.

destabilizonte situatën në Shqipëri dhe të rrezikonte prapavijën e trupave austro-hungareze në Ballkan⁶³.

Edhe në lidhje me çështjen e mëvetësisimit të klerit mysliman shqiptar, vihej re një dallim në qëndrimin e mbajtur nga autoritetet ushtarake dhe ato civile. Qarqet drejtuese ushtarake ishin për vendosjen e klerit mysliman shqiptar nën varësinë e Reis-Ul-Ulema të Sarajevës së Bosnjës. Madje, u arrit deri aty sa drejtuesit ushtarakë kërkuan ardhjen në Shqipëri të hoxhallarëve boshnjakë, që t'i mësonin shqiptarët myslimanë si duhej t'u bindeshin autoriteteve ushtarake. Ndërkohë, autoritetet civile austro-hungareze në Shqipëri me në krye Komisararin civil Kral i paraqitën qeverisë vjeneze projektin për emërimin e një kryemyftiu shqiptar që të drejtonte çështjet e fesë myslimane në Shqipëri. Për realizimin e këtij projekti, Kral i kërkoi Vjenës që të ndërhynte për marrjen e një lloj miratimi nga Sheh-Ul-Islami në Stamboll. Kreu i diplomacisë austro-hungareze, S. Burian dhe Komisari civil Kral kundërshtuan idenë e ushtarakëve për ardhjen e hoxhallarëve “shëtitës” në Shqipëri. Madje, Burian kundërshtoi edhe sugjerimin e Kral-it për marrjen e miratimit nga Sheh-Ul-Islami i Stambollit për emërimin e kryemyftiut të Shqipërisë. Ai argumentonte se pozita e fesë myslimane në Shqipëri nuk ishte e ngjashme me atë të Bosnjës, por ishte e njëjtë me atë të vendeve krejtësisht të pavarura. Ndonëse në fillim të okupimit vihej re se Vjena shfaqti hezitim ndaj idesë së emërimit të një kryemyftiu vendas në Shqipëri, por nga vjeshta e vitit 1916 deri në vjeshtën e vitit 1918, ajo punoi pa zhurmë dhe pa ndërprerje për mëvetësimin e shqiptarëve myslimanë nga varësia e Sheh-Ul-Islamit të Stambollit, rritjen e nivelit të përgatitjes dhe të ndërgjegjësimit kombëtar të klerit mysliman shqiptar, si dhe për institucionalizimin dhe konsolidimin e strukturës së Myftinisë së Shqipërisë.

⁶³ Sali Kadria, “Mbi disa çështje të administrimit politik dhe financiar të territorit të Shqipërisë të okupuar nga Austro-Hungaria gjatë viteve 1916-1918”, në *Studime historike*, nr. 3-4, 2018, botim i Institutit të Historisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, Tiranë: 2019, f. 94.

S u m m a r y

THE ATTITUDE OF THE AUSTRO-HUNGARIAN AUTHORITIES TOWARDS THE ALBANIAN MUSLIM POPULATION AND ITS CLERGY DURING 1916-1918

The article deals with the relations built by the Austro-Hungarian military and civilian authorities during 1916-1918, in relation to the Muslim and Catholic populations as well as the respective clergy. The author expresses the opinion that Austria-Hungary followed two lines of attitude towards religious beliefs in Albania. On the one hand, the Austro-Hungarian military authorities despised the Albanian Muslim population and tended to side with the Catholic population. On the other hand, the civil authorities and in particular the Civil Commissioner August Ritter von Kral tried to take into account the religious relations within the country, as they were clear that maintaining a unilateral stance could trigger a civil war in Albania.

Even regarding the issue of the independence of the Albanian Muslim clergy, there was a difference in the attitude held by the military and civil authorities. The leading military circles were for the establishment of the Albanian Muslim clergy under the subordination of Reis-Ul-Ulema of Sarajevo in Bosnia. Meanwhile, the Austro-Hungarian Foreign Affairs Minister Stephan Burián von Rajecz and the Civil Commissioner Kral drafted the project for the appointment of an Albanian chief mufti to direct the affairs of the Muslim religion in Albania.

At the beginning of the occupation of Albania, Vienna expressed reluctance to the idea of appointing a local chief mufti in this country. However, from the autumn of 1916 to the end of 1918, Austro-Hungarian civil authorities worked tirelessly and uninterruptedly for the independence of Muslim Albanians from the dependence of Sheikh ul-Islam of Istanbul, increasing the level of preparation and national awareness of the Albanian Muslim clergy, as well as for the institutionalization and consolidation of the structure of the Mufti of Albania.